



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Dëgjimi i pëgjithshëm publik mbajtur më 22.7.2026, i cili filloi në orën 14:00

Të pranishëm ishin: Drejtori i shëndetësisë - Bujar Gashi, drejtoresha e Financave - Valbona Makolli, nga drejtoria e Administratës- Shkëndije Krasniqi, drejtoresha e Mirëqenies Sociale- Adelina Sahiti, drejtori i Shërbimeve Publike- Leutrim Retkoceri.

Osman Bilaca: - përshëndetje për të gjithë. Atëherë po fillojmë me diskutimin për të cilin ju kemi ftuar. Sot kemi mbajtur diskutimin e tretë që është për hartimin e buxhetit për vitin 2027. Me theks të veçantë e kemi për kërkesat që vijnë prej qytetarëve për komplet sistemin partësor shëndetësor, por po ashtu edhe kërkesa të tjera që vijnë edhe prej personelit shëndetësor për hartimin dhe planifikimin e buxhetit që Drejtoria e Shëndetësisë për me i bërë për të gjitha institucionet varëse për vitin 2027.

Enver Redenica- asamblist: - e falënderoi Përparim Ramën, duke thënë se po promovon investimet e realizuara nga qeverisja e kaluar. Kritikoi mbylljen e barnatoreve dhe reduktimin e shërbimeve shëndetësore në fillim të mandatit. Tha se pas presionit qytetar, ambulanta në Velani riktheu orarin e plotë të punës. Theksoi se në ambulancën e Velanisë mungojnë pajisje, shtretër për infuzion, pediatër dhe barnatore. Kërkoi ndërtimin e një ambulate të re në Tokbahqe, për t'u shërbyer lagjeve Tokbahqe, Sofali dhe Bled. Tha se kjo kërkesë është bërë vazhdimisht që nga viti 2016, por ka mbetur pa përgjigje. Kërkoi që projekti të përfshihet në buxhetin e vitit 2027, duke theksuar se ekzistojnë toka publike dhe nevoja e qytetarëve.

Isa Rexha – qytetar: - theksoi se Barileva ka 6,537 banorë, ndërsa Drenovci rreth 1,000, por ambulanta punon vetëm deri në ora 14:00. Kërkoi zgjatjen e orarit të ambulancës deri në ora 20:00, për shkak të numrit të madh të banorëve. Tha se qytetarët detyrohen të shkojnë në Besi për shërbime bazë shëndetësore. Sqaroi se asnjëherë nuk ka kërkuar mbylljen e ambulancës për t'u bërë çerdhe, duke e quajtur këtë pretendim të pavërtetë. Shprehu shqetësim për mungesën e investimeve në Barilevë, duke përmendur çerdhen, rrugët, kanalizimin dhe ndriçimin.

Gëzim Sveçla – asamblist: - falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen e madhe në dëgjimin publik dhe inkurajoi personelin shëndetësor të paraqesë kërkesat e tyre. Theksoi se për vitin 2027 janë planifikuar rreth 1.3 milion euro investime në shëndetësi, por i konsideroi të pamjaftueshme për nevojat e kryeqytetit. Pyeti drejtorin cilat janë prioritetet për vitin 2027 dhe nëse është bërë

analizë për zonat ku nevojiten QMF të reja . Shprehu shqetësim se 250 mijë euro për pajisje mjekësore janë të pamjaftueshme për nevojat e shëndetësisë primare. Theksoi se shëndetësia dhe arsimi duhet të jenë prioritetet kryesore të ekzekutivit dhe kërkoi më shumë angazhim për investime.

Rrezart Halili – zëvendës drejtor i Qendrës kryesore të mjekësisë familjare Prishtinë: - theksoi se mungesa e stafit po ndikon në kapacitetin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Pyeti nëse planifikohet rritja e numrit të punëtorëve shëndetësorë në të ardhmen. Tha se me numrin aktual të punëtorëve nuk mund të përballohen të gjitha nevojat e qytetarëve.

Deli Avdiu- kryetar i këshillit të lagjes, paraqiti shqetësimet dhe kërkesat e banorëve lidhur me shërbimet publike në zonën e tyre. Ai theksoi se shtëpia e shëndetit punon vetëm në një ndërrim dhe nuk ofron shërbime gjatë fundjavës, andaj kërkohet zgjatja e orarit dhe organizimi i kujdestarisë. Po ashtu, u kërkua shtimi i një laboranti për të përballuar nevojat e qytetarëve. Avdiu vlerësoi punën e stafit shëndetësor, por theksoi mungesat në kapacitetet e shërbimit. Ai kritikoi mungesën e investimeve në infrastrukturë dhe vështirësitë e banorëve me transportin publik. Gjithashtu, shprehu pakënaqësi për mungesën e përfaqësuesve komunalë në debatet publike. Një çështje tjetër e ngritur ishte ndryshimi i emrit të lagjes nga “Çagllavicë” në “Prishtina e Re”, sipas kërkesës së banorëve dhe këshillave të lagjeve. Sipas tij, në këto lagje nuk jeton më komuniteti serb, prandaj emri aktual nuk përfaqëson realitetin. Në fund, ai kërkoi që gjatë planifikimit të buxhetit komunal të ndahen më shumë mjete për këtë zonë dhe për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Bernard Gegaj- ushtrues detyre i drejtorit të Poliklinikës Stomatologjike: - theksoi se pas investimeve të bëra në këtë institucion është paraqitur nevoja për zgjerimin e hapësirave të punës. Ai vlerësoi se rritja e kapaciteteve do të ndikonte në përmirësimin e kushteve për stafin dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve stomatologjike për qytetarët. Si zgjidhje, ai propozoi mundësinë e bashkimit të një hapësire që aktualisht nuk përdoret nga stomatologjia, por që më herët ka qenë pjesë e këtij shërbimi. Gegaj kërkoi shqyrtimin e mundësive ligjore dhe praktike që kjo hapësirë t’i rikthehet shërbimit stomatologjik.

Bujar Gashi - drejtor i Shëndetësisë: - tha se kërkesat dhe projektet që vijnë nga ju janë shumë të rëndësishme, pasi ju i njihni nevojat reale të institucioneve dhe punoni çdo ditë me pacientë. Jemi në proces të përfundimit të buxhetit dhe këto propozime do të na ndihmojnë në planifikimin e investimeve të ardhshme. Ju inkurajojmë që të vazhdoni të paraqitni kërkesat tuaja për infrastrukturë, pajisje dhe përmirësim të shërbimeve. Gjithashtu drejtori tha se sa i përket sektorit të shëndetësisë, investimet dhe angazhimet kanë vazhduar vazhdimisht ndër vite. Në sistemin shëndetësor jam i angazhuar prej 27 vitesh, ndërsa në pozita menaxhuese prej vitit 2016. Puna në kujdesin parësor shëndetësor nuk është ndalur dhe investimet kanë vazhduar në mënyrë të vazhdueshme. Ai theksoi se gjatë viteve të fundit janë renovuar rreth nëntë qendra të mjekësisë familjare në zona të ndryshme të Prishtinës. Janë renovuar QMF-të në Velani, Hajvali, Mati 1, Emshir, Besi, Bardhosh dhe qendra të tjera. Aktualisht janë duke u renovuar QMF-ja në Bregun e Diellit, Koliq dhe QMF-ja numër 5 në Ulpian. Nga viti 2021 deri në vitin 2026 janë investuar rreth 1.350.000 euro në pajisje mjekësore. Gjithashtu, rreth 1.550.000euro janë investuar në renovime të objekteve shëndetësore. Shërbimet në kujdesin parësor shëndetësor organizohen sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu drejtori theksoi se kërkesa për pediatër është e arsyeshme nga qytetarët, por aktualisht kufizohet nga rregulloret ekzistuese. Për shkak se Prishtina nuk ka

maternitet, nuk lejohet zgjerimi i këtij shërbimi në kujdesin parësor sipas udhëzimeve në fuqi. Sa i përket barnatoreve publike, aktualisht funksionon barnatorja qendrore në QKMF. Në këtë shërbim angazhohen farmacistë dhe teknikë të farmacisë, por kapacitetet aktuale nuk mundësojnë hapjen e shumë barnatoreve të reja. Një nga projektet e planifikuara për vitin 2027 është decentralizimi i barnatores qendrore. Ky projekt synon lehtësimin e furnizimit të pacientëve me barna dhe insulinë dhe uljen e ngarkesës në QKMF. Sa i përket shtretërve të emergjencës, ato nuk janë të parapara në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor. Koncepti i mjekësisë familjare bazohet kryesisht në parandalim dhe trajtimin e rasteve më të lehta. Drejtori theksoi se në mungesë të spitalit të qytetit, qendrat shëndetësore shpesh përballen me kërkesa përtej kompetencave të tyre. Edhe pse infuzionet dhe terapitë parenterale nuk janë pjesë e konceptit bazë të mjekësisë familjare, ato ofrohen kur paraqitet nevoja. Qëllimi kryesor është që qytetarëve t'u ofrohen shërbime sa më cilësore dhe të qasshme. Kërkesat e paraqitura nga profesionistët shëndetësorë do të merren parasysh gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve të ardhshme. Ai tha se bashkëpunimi me institucionet shëndetësore mbetet i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve. Bëri të ditur se institucionet e kujdesit parësor shëndetësor vazhdojnë të ofrojnë shërbime për të gjithë pacientët, edhe pse në disa raste ka pritje për shkak të ngarkesës. Sipas tij, Qendra e Mjekësisë Familjare në Velani trajton mesatarisht rreth 90 pacientë në ditë, ndërsa ngarkesa për mjek mbetet brenda standardeve të pranueshme. Ai theksoi se bazuar në statistikat aktuale, nuk ekziston nevoja për ndërtimin e një qendre të re të Mjekësisë Familjare në zonën e Sofalisë, megjithëse kjo çështje mbetet e hapur për t'u rishikuar në të ardhmen nëse rritet numri i banorëve dhe i pacientëve. Sqaroi se organizimi i kujdesit parësor bazohet në kriteret ligjore dhe demografike, ku hapja ose ngritja në nivel e një ambulance apo qendre varet nga numri i banorëve dhe ngarkesa me pacientë. Ai theksoi se Barileva aktualisht nuk i plotëson kushtet për funksionim në dy ndërrime apo për ndryshim të statusit të institucionit, pasi nuk arrin pragun e përcaktuar me ligj. Në raport me investimet, ai njoftoi se gjatë viteve të fundit janë realizuar dhe do të vazhdojnë renovimet e qendrave shëndetësore, furnizimi me inventar dhe pajisje të reja mjekësore, si dhe modernizimi i aparaturave diagnostikuese. Sipas tij, synimi është që gjatë vitit 2027 të përfundojë rinovimi i pajisjeve radiologjike dhe të vazhdojë përmirësimi i kushteve të punës në qendrat e kujdesit parësor. Ai shtoi se mbetet prioritet edhe avancimi i digjitalizimit të shërbimeve, ndonëse kjo varet nga zhvillimi dhe integrimi i sistemeve informative shëndetësore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Drejtori njoftoi gjithashtu se për vitin 2027 është planifikuar zbatimi i programit për intervenimin në fëmijërinë e hershme, i cili parasheh angazhimin e fizioterapistëve, psikologëve, logopedëve dhe punëtorëve socialë. Megjithatë, ai shprehu shqetësim për mungesën e mjeteve buxhetore për paga dhe mëditje, duke paralajmëruar se kjo mund të ndikojë në vazhdimësinë e kontratave të stafit shëndetësor dhe në zbatimin e plotë të programeve të reja. Në fund, theksoi se numri i punëtorëve shëndetësorë mbetet i pamjaftueshëm krahasuar me nevojat reale të kryeqytetit dhe se rritja e këtij numri varet nga grantet shtetërore dhe numri zyrtar i banorëve. Ai kundërshtoi propozimin që kujdesi parësor të organizohet vetëm në një ndërrim, duke vlerësuar se Prishtina, për shkak të rolit dhe ngarkesës së saj, duhet të vazhdojë të ketë qendra kujdestare që funksionojnë 24 orë, në mënyrë që të garantohet ofrimi i pandërprerë i shërbimeve shëndetësore për qytetarët.

Enver Redenica – asambleist:- falënderoi drejtorin për përgjigjet, duke theksuar se komunikimi më i rregullt përmes e-mailit do të kishte shmangur një pjesë të debatit në mbledhje.

Ai kritikoi tërheqjen nga premtimi për ndërtimin e një ambulance në zonën e Sofalisë, duke theksuar se kjo qendër do t'u shërbente edhe lagjeve përreth, si Tokbashqe, Bregu i Diellit dhe pjesës pranë shkollës Normale. Sipas tij, ekziston tokë publike për realizimin e projektit, ndërsa në mungesë të kësaj mundësie, komuna duhet të shqyrtojë alternativa që mundësojnë hapjen e një ambulance private, me qëllim përmirësimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet shëndetësore.

Redenica gjithashtu kërkoi mirëmbajtje dhe renovim më cilësor të të gjitha Qendrave të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, duke vlerësuar se investimet e deritanishme nuk kanë përmbushur pritjet, ndërsa përmendi si shembull QMF-në në Vranjevc/Velani, ku sipas tij cilësia e renovimit ka lënë për të dëshiruar.

Gëzim Sveçla: - asambleist, falënderoi drejtorin për sqarimet, duke vënë në dukje se ekziston një mospërputhje ndërmjet prioritetit të deklaruar për decentralizimin e ambulancave publike dhe mungesës së një kodi buxhetor për realizimin e këtij projekti.

Ai theksoi se planifikimi i shërbimeve shëndetësore duhet të mbështetet në statistika dhe në rrethanat reale, duke propozuar rristurimin e ambulancave në zonat rurale me numër të ulët banorësh. Sipas tij, bashkimi i shërbimeve për disa fshatra të afërta do të mundësonte shfrytëzim më efikas të stafit mjekësor.

Në fund, Sveçla ngriti një kërkesë konkrete për dislokimin e kontejnerëve pranë hyrjes së Qendrës së Mjekësisë Familjare nr. 3, duke vlerësuar se ata dëmtojnë pamjen e zonës dhe paraqesin rrezik për shëndetin publik. Ai kërkoi që, nëse është e mundur, kontejnerët të zhvendosen në një lokacion më të përshtatshëm.

Bujar Gashi: - drejtori i Shëndetësisë: - sqaroi se decentralizimi i barnatores nuk është paraparë si projekt kapital dhe për këtë arsye nuk ka një linjë të veçantë buxhetore. Ai theksoi se synimi është riorganizimi i hapësirave ekzistuese brenda institucioneve shëndetësore, pa ndërtim të objekteve të reja.

Sipas tij, fillimisht është menduar që një barnatore të vendoset në QMF-në nr. 5 në Ulpianë ose në një qendër tjetër, me qëllim lehtësimin e ngarkesës dhe shkurtimin e kohës së pritjes së qytetarëve për marrjen e barnave. Ky proces do të kërkojë vetëm përshtatje të hapësirave dhe pajisje të nevojshme, pa investime të mëdha kapitale.

Leutrim Retkoceri- drejtori i Shërbimeve Publike: - bëri të ditur se Komuna është duke hartuar një plan për rishikimin dhe zhvendosjen e lokacioneve të kontejnerëve në të gjitha lagjet e Kryeqytetit, me fokus të veçantë në zonat që përballen me problemet më të mëdha. Sipas tij,

ndërhyrjet do të realizohen në faza, ndërsa plani do të prezantohet edhe para Kuvendit Komunal dhe në dëgjim publik përpara fillimit të zbatimit.

Ai theksoi se institucionet publike, përfshirë Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. 3, do të kenë përparësi në këtë proces, megjithëse ndërhyrjet kërkojnë kohë për shkak të përgatitjeve teknike dhe organizative.

Retkoceri njoftoi gjithashtu se, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë, për herë të parë në Kryeqytet po realizohet një aksion i dezinfektimit, deratizimit dhe pastrimit të lokacioneve të kontejnerëve. Ai vlerësoi se ky bashkëpunim synon të rrisë sigurinë shëndetësore të qytetarëve, veçanërisht gjatë periudhës së temperaturave të larta dhe shtimit të mbeturinave.

Osman Bllaca :- theksoi se Qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat përballen edhe me sfida të tjera, përveç atyre të diskutuara, veçanërisht në fushën e trajnimit dhe ngritjes profesionale të stafit, si dhe në zhvillimin e teknologjisë, e cila sipas raporteve të auditimit mbetet në nivel të pamjaftueshëm.

Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e mirëmbajtjes dhe renovimit cilësor të objekteve shëndetësore, duke theksuar se Komuna ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e kontratave të renovimit. Sipas tij, edhe stafi i institucioneve duhet të jetë më vigjilent gjatë realizimit të punimeve, në mënyrë që të sigurohet cilësia e tyre dhe të shmangen problemet pas përfundimit të renovimeve.

Në përmbyllje, Bllaca falënderoi pjesëmarrësit për kontributin në diskutim dhe i ftoi ata të marrin pjesë edhe në dëgjimet e ardhshme publike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2027,
22.7.2026

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Behim Musli	Musli	M.F		
2	Shefki	Zhushci	MR		
3	Dr. Shyqrie Melaku	Shullaj	Mjek. Familjar		
4	Dr. Rushit Isma	Ismajli	M.F.		
5	Ylber	Kozma	Inf. AMF XI		
6	Fitore	Buzuku	Infermiere p.		
7	Donikë	Novoselia	INF. PËRGJEGJËS		
8	Arjeta	Shaqiri	Koed. SISHT		
9	Flouze	Rashani	Inf. Përgjegjës		
10	Xhevrirje	Canolli	M.F		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Nebi Sylejman		M.F.		
12	Dr. SUZANA	RUSHITI	M. FAMILJARE		
13	Dr. Kime	Jashari	M. Familjare		
14	Blinerë	Bytyqi	Shërbim Palliativ		
15	Sahadete fdr	Kelmendi	M. Familjare		
16	SAPRERA	KRASNIA	Spic. e kujdes fam.		
17	Lisjeta	Emiri	Infermiere		
18	Beiroud	Arçaj	Udh. dhe p. sh.		
19	Dilou	Moniu	q. a. kryeinfurmer		
20	ARIETA	PULA	Mjek. P. sh.		
21	Violeta	Haxhiq-Nobrdali	M. Familjare		
22	Malvde	Soluh	Infermiere		
23	Gëzim	SVECLA	Qytetar		
24	Emir	Rednica	g. sh.		
25	INSA	Polis	K. sh. J. sh.		
26	EDITA	BAJRAKARI	RADIOLOG		
27	FIKRIE	ADEMI	INFERMIERE		
28	MIHANE	PESTINHA	INFERMIERE		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen! *

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------

29	Dr. Leonard	Krasniqi	M. Familari		
30	Shkelqim Shkurtaj	Shkurtaj	Shkurtaj		
31	Reza Haxhi	Haxhi	Haxhi		
32					
33	Valdet Hashani	direktor	QKMF Pr.		
34	Merita Kongjeli	Kryeshtetese	QKMF Pr.		
35	Lindona Hajdari	Prerexhe	QKMF-VI		
36	Shkurtaj Gjergji	Anëtar e KC	QKMF		
37	Dr. Endrit Toru	Mjekës përgjithorë	QKMF - KC		
38	ZHAKA UKA	Z. Iart Financiar	DSH		
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!